



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 15.7.2019

Lënda: Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 15.7.2019, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, konfirmuar në detyrë me vendimin nr. 61, datë 2.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të trupit gjykues,

Pasi u njohëm me shpjegimet dhe provat e dorëzuara nga ana e subjektit të rivlerësimit, në seancën e mëparshme, të datës 11.7.2019, Komisioneri Publik vlerëson se, nga ana formale, aktet dhe provat e paraqitura nga subjekti përmbushin kërkesat ligjore për t'u administruar në cilësinë e provës.

Duke krahasuar këto prova dhe shpjegimet përkatëse të subjektit të rivlerësimit në seancën e kaluar, në raport me shkaqet e ngritura në ankim, Komisioneri Publik, në analizë dhe të përmbajtjes së tyre, parashtron si në vijim:

I. Mbi burimin e ligjshëm të huas

1.1 Subjekti ka paraqitur: (i) Ekstrakt të llogarive të sigurimeve shoqërore, lëshuar më datë ***.2.2019, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (italian) (*prova nr.1*) dhe (ii) vërtetim për ngarkesë zero, lëshuar më datë ***.2.2019, nga Agjencia e të Ardhurave (*prova nr.2*).

1.2 Lidhur me provën nr.1, ajo pasqyron, përveç sa ka qenë administruar në dosje të Komisionit, edhe të ardhura të tjera me kontribut nga *Arka e Integritimit*. Nga verifikimi i këtij akti rezulton se, krahas të ardhurave të deklaruara në deklaratat CUD, personi tjetër i lidhur, huadhënësi, ka përfituar dhe shumë në total bruto prej 10.528 euro¹.

1.3 Komisioneri Publik, në shkaqet e ngritura në ankim, lidhur me burimin e ligjshëm të huas ka konstatuar se nga aktet e vëna në dispozicion (*Deklaratat CUD*), të ardhurat neto të personit tjetër të lidhur janë të mjaftueshme vetëm për të mbuluar shpenzimet e jetesës në shtetin italian. Sa më sipër, akti i ri i paraqitur nuk ndryshon në thelb mundësinë financiare të personit të tjetër të lidhur, për të mbuluar me të ardhura të ligjshme huan e deklaruar.

¹ Subjekti i rivlerësimit edhe në parashtrimet e tij thekson se këto të ardhura të deklaruara janë BRUTO.

- 1.4 Lidhur me provën nr. 2, e cila konfirmon që personi tjetër i lidhur, deri më datë ***.2.2019, nuk rezulton të ketë detyrime (borxhe) ndaj Komunës. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, ky dokument nuk sjell ndonjë risi mbi shkaqet e ankimit.
- 1.5 Në përfundim të sa më sipër, provat dhe aktet e paraqitura mbi këtë shkak ankimi nuk mund të konsiderohen si dokumentacion justifikues ligjor mbi burimin e ligjshëm të huas, sikundër ato nuk provojnë dhe vërtetojnë ekzistencën e kësaj marrëdhënie huaje, duke provuar ndër të tjera edhe mënyrën se si huaja ka mbërritur te subjekti i rivlerësimit².
- 1.6 Kjo do të ishte e nevojshme me qëllim krijimin e bindjes mbi vërtetësinë e kësaj marrëdhënie huaje, pasi megjithëse ajo është deklaruar nga subjekti në DV. 2009, subjekti nuk e ka bashkëlidhur kontratën e huas në deklaratën Vetting, referuar kjo dhe udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, “Për mënyrën e deklaramit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- 1.7 Sjellim në vëmendje se Komisioneri Publik, gjatë kryerjes së analizës financiare në shkaqet e ankimit, ka prezumuar të mirëqenë marrëdhënien e huas dhe pasojat e kësaj marrëdhënie, siç do të trajtohet në vijim.

II. Mbi burimin e ligjshëm të krijimit të dhurimit të shumës 1.500.000 lekë

2. Subjekti, në seancën e datës 11.7.2019, ka paraqitur: (i) Shkresën nr. *** prot., datë ***.7.2019, të ILDKPKI-së, mbi shpenzimet e jetesës për frymë dhe familjare sipas INSTAT, për vitet 2003-2016 (*prova nr.3*); (ii) Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të babait të bashkëshortes, për periudhën prill 2002 – dhjetor 2008, të sigluar nga punëdhënësi dhe nga punonjësi i autorizuar i ISSH-së, mbi të ardhurat e babait për këtë periudhë (*prova nr.5*).
- 2.1 Komisioneri Publik, në shkaqet e ankimit lidhur me burimin e ligjshëm të dhurimit, është bazuar në të dhënat e disponuara në dosjen e Komisionit, ku të ardhurat e babait të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit ishin marrë referuar lëvizjeve të llogarisë bankare të këtij të fundit, pranë BKT.
- 2.2 Për sa më sipër, referuar këtyre provave të reja (*prova nr.5*), në konsideratë dhe të dhënave mbi të ardhurat e bashkëshortes së subjektit për periudhën 2002-2008, si dhe duke llogaritur shpenzimet e jetesës sipas të dhënave të paraqitura në provën nr. 3, shkresa e INSTAT-it për të njëjtën periudhë, rezulton se personat e tjerë të lidhur mbulojnë me burime të ligjshme shumën e dhuruar prej 1.5 milionë lekë.

² Referuar dhe jurisprudencës së KPA-së, në vendimin nr. 12, datë 17.12.2018, f. 15; Vendimi nr. 6, datë 28.2.2019.

III. Mbi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të shlyer (i) këstet e apartamentit dhe (ii) huas

3. Komisioneri Publik, në vëmendje dhe të orientimit të dhënë nga Kolegji i Posaqëm i Apelimit, në prg. 39 të vendimit (JR), nr.7/2019, në shkaqet e ankimit, ka analizuar mbi mundësinë financiare të subjektit për të shlyer këstet e apartamentit dhe huas, bazuar në sa vetë subjekti ka deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë në deklaratat periodike vjetore.

3.1 Subjekti, në seancën e datës 11.7.2019, mbi diferencat e konstatuara në shpenzimet dhe kursimet e viteve 2005, 2009, 2011, 2012 dhe 2013, ka sqaruar se gjatë këtyre viteve ka deklaruar në mënyrë të pasaktë e të paplotë ndryshimin e pasurive, duke paraqitur vit pas viti vetëm shtesat e pasurive dhe jo pakësimet e tyre, si dhe ka deklaruar *kursimet në cash*, duke pasur parasysh këtu edhe kursimet në llogaritë bankare.

3.2 Ky shpjegim i subjektit është në kundërshtim dhe me ligjin nr. 9049/2003, “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*”, të ndryshuar.

3.3 **Lidhur me pagesën e këstit të apartamentit në vitin 2009.** Subjekti ka ritheksuar se shlyerja e këstit të apartamentit nuk është bërë në mars të vitit 2009, sikundër reflektohet në mandat-arkëtimin e vënë në dispozicion nga shoqëria “****” sh.p.k., por deri në fund të vitit 2009.

3.4 Komisioneri Publik, ashtu sikurse kemi arsytuar dhe në shkaqet e ankimit, mandati i arkëtimit i paraqitur nga shoqëria “****” sh.p.k., në raport me shpjegimet kontradiktore të paraqitura nga kjo shoqëri apo me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, vlerëson se mandati i marsit 2009 ka vlerë të plotë provuese, pasi në të paraqitet situata reale faktike e veprimit juridik të pagesës së këstit. Subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme këstet e paguara deri më ***.3.2009, në vlerën - **1.041.085** (një milion e dyzet e një mijë e tetëdhjetë e pesë) lekë.

3.5 Edhe në prezumim të shpjegimeve të subjektit mbi pagesën e këstit të apartamentit në fund të dhjetorit të vitit 2009, sërish rezulton se subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme pagesat e apartamentit dhe kursimet e krijuara deri në fund të vitit 2009, për një diferencë negative prej - **890,349** (tetëqind e nëntë dhjetë mijë e treqind e dyzet e nëntë) lekë³.

3.6 **Lidhur me shlyerjen e kësteve të huas.** Komisioneri Publik ka konstatuar pamundësinë e mbulimit me burime të ligjshme të pagesave/shlyerjeve të huas dhe krijimin e kursimeve. Sikundër argumentuar më sipër, analiza është bazuar në sa vetë subjekti ka deklaruar në deklaratën e interesave periodike vjetore.

3.7 Bazuar në pretendimet e subjektit të rivlerësimit, u rishkuan të dhënat e disponuara mbi verifikimin dhe llogaritjen e të ardhurave nga pagat, sipas lëvizjeve në llogaritë bankare. Gjithashtu, shpenzimet e jetesës u llogaritën sipas *provës nr. 3*, të konfirmuar nga INSTAT-i. Nga këto verifikime rezulton se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe

³ Llogaritjet janë rishkuar bazuar në pretendimet e subjektit mbi të ardhurat nga paga për subjektin dhe bashkëshorten, verifikuar sipas lëvizjeve të llogarive bankare. Për pagesat e kësteve gjatë vitit 2009, për konvertimin e shumave të pagesave në euro, janë marrë në konsideratë pretendimet e subjektit gjatë shpjegimeve të tij. Shpenzimet e jetesës janë llogaritur rishkuar sipas provës 3 të subjektit. Për sa i përket provave nr. 6 dhe 7, të paraqitura nga subjekti, në ankimin e Komisionerit Publik, shpenzimet e udhëtimit për vitin 2009 janë llogaritur sipas pretendimeve të subjektit në parashtrësitë e rezultateve të hetimit, pra shumat për të cilat subjekti ka paraqitur provat nr. 6 dhe 7, nuk janë ngarkuar në shpenzimet personale të subjektit të rivlerësimit.

kursimet për vitin 2011, në shumën 1,044,035 (një milion e dyzet e katër mijë e tridhjetë e pesë) lekë, dhe për vitin 2013 në shumën 1,145,915 (një milion e njëqind e dyzet e pesë mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) lekë⁴.

IV. Mbi burimin e ligjshëm të autoveturës tip “VW Golf”

4. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, rezulton se: (i) në **DV 2004** subjekti ka deklaruar në formatin ku kërkohet të deklarohen shtesa dhe pakësime të pasurive, konkretisht: para *cash*, 750.000 lekë, data e krijimit ****.12.2004*; (ii) në **DV 2005** subjekti ka deklaruar, në formatin ku kërkohet të deklarohen shtesa dhe pakësime të pasurive, konkretisht: gjendje *cash* 400.000 lekë; (iii) në **DV 2009** ka deklaruar në f. nr. 6: *deklaroj nën përgjegjësinë time se, për shkak ngatërrese në objekt në DV 2005, nga ana ime nuk është deklaruar tjetërsimi i pasurisë së atij viti dhe vitit të mëparshëm, nga cash në blerjen me këto sasi lekësh të një automjeti Golf, në datë ****.7.2005*, me vlerë 450.000 lekë. Pakësuar 450.000 lekë. (Shënuar nga subjekti me shkrim dore.)*
- 4.1 Sikundër vërehet nga deklaratimet periodike vjetore dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në parashtrimet e tij, deklaratimet kanë mospërputhje. Saktësimi që subjekti i rivlerësimit ka bërë në vitin 2009, mbi kursimet *cash*, nuk qëndron në linjë logjike me kërkesat e formularit të deklaratimit të pasurive dhe me deklaratimet ndër vite të vetë subjektit. Bazuar në deklaratimet vjetore të subjektit të rivlerësimit, konstatojmë se ai nuk ka kryer deklaratim të saktë dhe të mjaftueshëm për vitin 2005.

KOMISIONERI PUBLIK
Darjel SINA

⁴ Llogaritjet janë rishkuar bazuar në pretendimet e subjektit mbi të ardhurat nga paga për subjektin dhe bashkëshorten, verifikuar sipas lëvizjeve të llogarive bankare. Shpenzimet e jetesës janë llogaritur rishkuar sipas provës 3 të subjektit.